

**PROF. LEONARD TOPUZI – PEDAGOG
SHËMBULLOR I BOTANIKËS NË FSHN, UT – ME
RASTIN E 80-VJETORIT TË LINDJES**

MIHO A.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë,

Të parashikosh mirë të ardhmen duhet të njohësh mirë të kaluarën, thotë një fjalë e urtë. Kjo më shumë se kurrë ka vend mes nesh si edukatorë të rinisë për breza të tërë në vite. Kjo ishte shtysa për këtë Shkrim në nderim të ditëlindjes së 80-të të kolegut tonë, Prof. Leonard Topuzi. Kjo përmbush jo vetëm një detyrim që ne kemi ndaj Tij dhe ish mësuesve dhe kolegëve tanë më të vjetër, por edhe si nevojë që ne dhe ata që do të vijnë pas nesh të njohim dhe të ruajmë të freskët kujtimet për të shkuarën, përpjekjet, sakrificat, arritjet dhe zhgënjimet e saj. Vetëm në këtë mënyrë, ne do të forcojmë më mirë unitetin tonë në punë, do të mund të përballojmë më mirë dhe me sukses vështirësitë e kohës, do të përmbushim sa më mirë misionin tonë për edukimin e brezit të ri, sa fisnik, po aq dhe të vështirë. Për më tepër, kjo Ceremoni përkon edhe me afrimin e Ditës së Mësuesit, ngjarje e shënuar për arsimin shqiptar.

Prof. Leonard Topuzi **lindi dhe u rrit** në qytetin e Elbasanit, në lagjen Kala të këtij Qyteti, një lagje plot histori dhe tradita. Këtu ai mbaroi studimet parauniversitare. Ishte një nga nxënësit e dalluar të shkollës Normale (Pedagogjike), e para shkollë e mesme kombëtare, vatër e përgatitjes së mësuesve në gjuhën shqipe. Në periudhën 1958-1963, ndjek studimet për Biologji-Kimi, të cilat pjesërisht u kryen për një vit në Universitetin Shtetëror të Shën Petersburgut ‘Zhdanov’, Rusi, dhe më pas u përfunduan në FShN, UT.

Duke filluar nga viti 1962, Profesori **fillon të punojë** si bashkëpunëtor shkencor pranë Katedrës së Botanikës (sot Grupi Mësimor i Botanikës), FShN, UT, dhe shpejt (prej vitit 1963) në pedagog, po pranë kësaj Katedre, vend pune që e mbajti deri sa doli në pension në vitin 2001. Edhe pas daljes në pension, Profesori vazhdoi të jetë anëtar i jashtëm i Grupit tonë të Botanikës duke vazhduar mësimdhënien për shumë vite më pas.

Ai ka qënë për shumë vite si drejtues apo përfaqësues në forumet e Universitetit të Tiranës dhe gjetkë: 1963-65, nëndrejtor i Institutit Pedagogjik 2-vjeçar ‘A. Xhuvani’, Tiranë; 1975-78, drejtor pranë Shkollës së Mesme Mjekësore, Elbasan; 1988-92, ka drejtuar Katedrën e Botanikës, FShN, UT; 1984-90, anëtar i Këshillit Shkencor të FShN; 1989-90, anëtar i Këshillit Shkencor të Departamentit të Biologjisë; 1993-97, anëtar i Këshillit Botues të Buletinit të Shkencave Natyrore, i botuar rregullisht nga FShN. Për punën e Tij të palodhur,

plot pasion, durim dhe profesionalizëm, qoftë në mësimdhënie, në kërkim dhe në drejtim, Prof. Topuzi është dekoruar në vitin 1980 me Urdhërin 'Naim Frashëri', të Klasit të II-të, kurse në 1989 me Urdhërin e Punës, po të Klasit të II-të.



Profesor Topuzi gjatë një seance laboratorit në Botanikë, FShN, UT, në vitet 1980

Prof. Topuzi ka ndihmuar në ecurinë, mbarëvajtjen dhe reformimin në vite të **lëndës së Botanikës së Përgjithshme**, ku Ai ishte titullar deri sa doli në pension. Kjo është lëndë bazë formuese për Shkencat Biologjike, por dhe ato Farmaceutike. Ndikimi i drejtpërdrejtë ka qenë këtu në ngritjen e laboratorit të Botanikës, të programit të lëndës, të leksioneve, laboratorëve dhe praktikave në terren, gjithë fuqizimin dhe përsosjen e tyre. Edhe sot e kësaj dite kjo lëndë, si në Biologji (*Bachelor*) dhe në Farmaci (sot pranë UMT) ruan shumë në përmbajtjen e saj teorike dhe praktike, atë që është ngritur shumë vite më parë. Edhe sot Ai është bashkëautor i tekstit mësimor të kësaj lënde, si dhe autor i Praktikumit të Botanikës, thujse të vetmit edhe në mbarë hapësirën shqiptare. Si e tillë, kjo lëndë ka qenë dhe mbetet gjithmonë e pëlqyer dhe vlerësuar edhe nga studentët.

Veprimtaria shkencore e Profesorit zë fill menjëherë me fillimin e punës pranë Fakultetit. Fusha kërkimore ka qenë e përqendruar fillimisht në studimin e florës dhe të bimësisë së barishteve të këqia, në studime floristike dhe gjeobotanike të gjinisë *Festuca* (bimësi gramore), të gështenjës (*Castanea*), në etnobotanikë etj.

Doktorata e Tij e përfunduar në vitin 1984 ka qënë e lidhur me studimin e florës dhe bimësisë së barishteve të këqia në rrethin e Elbasanit. Pas përfundimit të doktoratës, Profesori i jepet në atë kohë grada ‘Kandidat i Shkencave’, kurse në 1988 fiton titullin ‘Docent’. Këta u barazvlerësuan, me gradën shkencore ‘Doktor i Shkencave’ në 1994, dhe po në këtë vit i jepet titulli ‘Profesor’. Përveç punimit të doktoratës, ka botuar edhe shumë artikuj shkencorë, ka referuar në takime kombëtare apo ndërkombëtare, si dhe ka udhëhequr disa doktorata dhe shumë diploma me studentë të biologjisë.

Profesori dallohet për **pjesë dhe shkallë të lartë intelektuale**, por edhe për thjeshtësi dhe modesti, duke ruajtur ekuilibrat e duhur, edhe në kthesat e rënda të historisë sonë. Ka treguar gjithmonë maturi dhe ndershmëri jo vetëm në marrdhëniet me studentët, por edhe me kolegët. Ai mbante afër dhe ndihmonte me durim dhe urtësi, në kryerjen e detyrave të ngarkuara, veçanërisht të rinjtë asistentë dhe studentët. Është dalluar si pedagog shëmbullor, i aftë në zhvillimin e lëndës së Botanikës, model në ligjërime, i qartë dhe mjaft metodik, gjithmonë i qeshur dhe plot humor, duke zotëruar në mënyrë të përsosur auditorin dhe për gjithë kohën nga fillimi deri në fund, shumë i duruar në provime dhe i drejtë në vlerësimin e çdo studenti, mbështetës dhe në ndihmë për zgjidhjen e halleve të tyre, por edhe i rreptë në ndonjë sjellje të padenjës, por kjo gjithmonë jo me rrëmbim, por ‘të vriste me pambuk’, si thotë populli. E gjithë kjo ka qënë edhe përvojë e mirë në mësimdhënie edhe për Ne të tjerët, për më të rinjtë dhe për shumë mësues të biologjisë.

Në këtë karrierë të gjatë të Tij, Profesor Topuzi është ish nxënës dhe **bashkëpunëtor i ngushtë** i themeluesve të degës së Biologjisë, FShN, dhe vetë Universitetit të Tiranës, si K. Paparisto, M. Demiri, I. Zeko, I. Mitrushu, S. Mborja, Xh. Qose, L. Gjikhuri, S. Kongjika etj. Ky Shkrim është përkujtim edhe për këto Figura të rëndësishme jo vetëm për Biologjinë, por për gjithë Arsimin tonë të Lartë.

Një tjetër aspekt që nuk mund të mos përmendet për Prof. Topuzin është **veprimtaria shoqërore**. Në moshën e tij rinore, Ai është dalluar si aktivist i përkushtuar i rinisë. Profesori mbetet sot dëshmitar i asaj periudhe shumë të vështirë, por edhe plot pasion dhe ideale për të mëkëmbur vendin, dhe për të arsimuar në gjithë shtresat e popullsisë së varfër dhe të paditur, por të etur për dije, kulturë dhe progres. Shumë nga virtytet e karakterit të fortë intelektual që buronin nga origjina e tij, arsimimi brenda dhe jashtë vendit, të gjitha sëbashku gjendeshin të mishëruara edhe tek figura e Tij. Ne që kemi punuar për vite me radhë sëbashku mund të pohojmë se në gjithë veprimtarinë Ai është dalluar gjithmonë për kulturë dhe profesionalizëm. Sikur politikanët tanë të sotëm të kishin shpirtin dhe idealet e Profesori! Ai përpiqej që çdo direktivë të mos zbatohet në mënyrë të verbër, por t’i shërbente sa më mirë mësimdhënies, kërkimit, por dhe ngritjes morale, edukimit, sidomos të rinisë studentore. Kjo

ishite gjithmonë më se e domosdoshme për kohën, po të mendojmë për prapambetjen e thellë që kishte trashëguar Shqipëria nga shekujt.

Për Profesorin Fakulteti, mësimi, puna me studentët ishin gjithçka. Dhe këtë Ai e bënte shumë natyrshëm, pa lodhje, plot pasion dhe përkushtim. Ne nuk e kemi parë një herë të nxehur, apo të rrëmbyer, pavarësisht nga puna jo shumë e lehtë me njerëzit, dhe nga situata nga më të ndryshmet që krijohen herë pas here, më të theksuara këto në vitet e para të tranzicionit pas viteve 1990-të. Falë kujtesës së tij të shkëlqyer nuk mungon edhe sot në takimet me ish studentë, të cilët për hir të së vërtetës janë të shumtë për këtë karrierë të gjatë. Kujtimet e Tij dhe rrëfimet për kohën e shkuar freskojnë gjithmonë këto takime. Është për t'u patur shembull pjekuria, mënçuria, durimi, përfshirë këtu dhe humori i tij, të cilat shoqërojnë bisedat tona, ndonjëherë dhe me ndonjë kundërshtar të flaktë bindjesh që nuk mungon sot mes nesh.

Ashtu i gjallë, plot kurajo për moshën dhe plot urtësi, Profeshori është përditë i pranishëm mes nesh, dhe me këshillat e tij mbetet gjithmonë një figurë e nderuar për të gjithë ne kolegët dhe ish studentët, shembull në misionin tonë të edukimit të brezit të ri. Në këtë përvjetor të 80-të të Ditëlindjes i urojmë me përzemërsi 'Gëzuar e Përshumë Vjet! Jetë të gjatë!', jo vetëm nga ne të Grupit Mësimor të Botanikës, por në emër edhe të gjithë anëtarëve të tjerë të Departamentit, të Kopshtit Botanik, Herbarit dhe Muzeut të Shkencave, por dhe në emër të shumë ish studentëve dhe dashamirësve të tjerë të shumtë në Fakultet dhe më gjerë.

Më sipër pohova se Profesor Topuzi është ish nxënës dhe bashkëpunëtor i ngushtë i themeluesve të degës së Biologjisë. Me këtë rast, dëshiroj t'i kushtoj këtu një homazh të veçantë ish Kolegut tonë, Profesor Stefo Kongjikës, i cili u nda nga Ne verën e kaluar (korrik 2015). Prof. Kongjika ishte punonjës mësimor në FShN nga vitet 1957-të e deri në vitin 1993 kur ai doli në pension, titullar i lëndës së Fiziologjisë Bimore një tjetër lëndë formuese e degës së Biologjisë, themelues i Labororit të Fiziologjisë Bimore, drejtues për disa vite me radhë i Katedrës së Botanikës, dhe drejtues në forumet e FShN-së. I përjetshëm qoftë kujtimi i Tij!

Jeta rrjedh sipas Kodeve të saj dhe për këdo, pas vitesh pune e përpjekjesh, vjen një ditë, e cila përkon me Ditëlindjen, që në bazë të Kodeve në fuqi lind e drejta për të dalë në Pension. Për këtë në fund të këtij Shkrimi dëshiroj edhe një herë që Prof. Topuzit, por dhe të gjithë kolegëve sot në Pension, t'u urojmë nga zemra 'Jetë të gjatë!', dhe t'i sigurojmë se vendi i tyre do jetë i lirë mes nesh. Ata do të jenë gjithmonë të mirëpritur sa mundësia t'ua lejojë.